

REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVO
KOMUNA E VUSHTRISË-OPŠTINA VUÇITRN

Nr. / Br 509/23

Nr. Iq. / Br. st _____

Data: / Datum 02.05.2023

VUSHTRRI - VUÇITRN



REPUBLIKA E KOSOVËS - KOMUNA VUSHTRRI
Kryetari



Bazuar në nenin 13 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040, nenin 35 pika 8 të Ligjit për Arsimin Para Universitar në Republikën e Kosovës nr. 04/L-032, nenin 12 paragrafi 3 nën paragrafi 3.1 të Udhëzimit Administrativ nr. 151/2020 për Detyrat dhe Përgjegjësitë e Drejtorit dhe Zëvendësdrejtorit të Institucionit Publik Edukativo Arsimor dhe Aftësues Para universitar në Republikën e Kosovës Procedurat e Zgjedhjes dhe Emërimit Përfundimit të Kontratës dhe Emërimit të Përkohshëm, nenin 44 paragrafi 1 të Statutit të Komunës si dhe në bazë të propozimit të Drejtorit për Arsim 10Nr. 329/23, Kryetari i Komunës me datën 02.05.2023 merr këtë:

V E N D I M

1. znj. **Merita Bajrami**, emërohet përkohësisht Drejtoreshë e Institucionit Parashkollor "Foleja" paralelja e ndarë te SHF "Ali Kelmendi" në Vushtri.
2. Emërimi në pozitën e cekur në pikën paraprake bëhet për periudhën kohore 02.05.2023 deri në përfundimin e procedurave të konkursit për plotësim të këtij vendi të punës.
3. Për zbatimin e këtij vendimi obligohet Drejtoria për Arsim në Vushtri.
4. Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit.




Ferit Idrizi

Kryetar i Komunës

Vendimi iu dërgohet:

- Drejtorit të Drejtorisë për Arsim
- znj. Merita Bajrami
- Arkivit të Sekretarisë



REPUBLIKA E KOSOVËS
KOMUNA VUSHTRRI


Bazuar në nenin 13 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale nr.03/L-040 dhe nenit 44 paragrafi 1 të Statutit të Komunës, dhe nenit 5, pika 1, nënpika 1.1 dhe neni 12 pika 1 nënpika 1.1 të Rregullores së Kuvendit të Komunës të Vushtrrië Nr.03/2023 për Përcaktimin e Kritereve të Ndarjes së Mjeteve Financiare nga Fondi për Transfere dhe Subvencione personave juridikë – OJQ-ve dhe ndihmë momentale personave fizikë dhe bashkëfinancim Nr.49/23 të dt.23.02.2023, si dhe në bazë të kërkesës 02-104/02-18134/23 të dt.26.04.2023, Kryetari i Komunës merr:

V E N D I M

1. OJQ-së Orda në Vushtrri, në emër të komunitetit turk, i lejohet një mbështetje financiare në shumë prej 500 € (pesëqind euro) për krentimin e Ditës së turqve.
2. Shuma e mjeteve të cekura si në pikën paraprake të këtij vendimi duhet të paguhet nga Zyra e Kryetarit – fondi për transfere dhe subvencione.
3. Pas përfundimit të projektit, pala duhet të sjell një Raport kthyes, për mënyrën e shfrytëzimit të mjeteve.
4. Zbatimin e këtij vendimi do ta bëjë Drejtoria për Buxhet dhe Financa në Vushtrri.
5. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.




Kryetari i Komunës


Ferit Idrizi

Vendimi ju dërgohet:

- Drejtorisë për Buxhet dhe Financa
si dhe
- Arkivit të Sekretarisë



REPUBLIKA E KOSOVËS - KOMUNA VUSHTRRI
Kryetari

Bazuar në nenin 13 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040 dhe nenin 44 paragrafi 1 të Statutit të Komunës, si dhe në batë kërkesës së Kryqit të Kuq të Kosovës, dega në Vushtrri nr.03/2023, datë 07.04.2023, Kryetari i Komunës merr këtë:

V E N D I M

1. Aprovohet kërkesa e Kryqit të Kuq të Kosovës dega në Vushtrri për ndarje të mjeteve financiare nga buxheti i komunës në shumë deri në 480.00 € (katërqind e tetëdhjetë euro) në muaj, për mbulim të shpenzimeve (të udhëtimit dhe nga një shujtë ditore në vlerë deri në 2.50 €) për vullnetarë të angazhuar në aktivitete humanitare në Komunën e Vushtrrisë.
2. Pagesa e mjeteve të specifikuar në pikën paraprake të këtij vendimi të bëhet në llogari bankare të Kryqit të Kuq dega në Vushtrri për periudhën kohore, 07 prill deri më 31 dhjetor 2023, nga buxheti i Drejtorisë për Shëndetësi dhe Përkujdesje Sociale – subvencione dhe transfere.
3. Pagesat duhet të kryhen pas dorëzimit në komunë të: faturave mujore për shpenzimet e ushqimit dhe udhëtimit të specifikuar dhe konfirmuara me nënshkrim nga Kryqi Kuq i Kosovës dega në Vushtrri si dhe raportit të organit mbikëqyrës të komunës për mbikëqyrje të zbatimit të këtij vendimi.
4. Për zbatimin e këtij vendimi obligohen: Drejtoria për Shëndetësi dhe Përkujdesje Sociale dhe Drejtoria për Buxhet dhe Financa.
5. Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit.

Ferit Idrizi
Kryetar i Komunës

Vendimi iu dërgohet:

- Drejtorisë për Shëndetësi dhe Përkujdesje Sociale
- Kryqit të Kuq, dega Vushtrri
- Arkivit të Sekretarisë

REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVO
KOMUNA E VUSHTRRIË-OPËSTINA VUÇITRIN

02 Nr. / Br 548/23

Nr. i fq. / Br. st _____

Data: / Datum 05.05.2023

VUSHTRRI - VUÇITRIN



REPUBLIKA E KOSOVËS - KOMUNA VUSHTRRI
Kryetari



Bazuar në nenin 13 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale nr. 03/L-040 dhe nenin 44 paragrafi 1 të Statutit të Komunës, Kryetari i komunës merr këtë:

V E N D I M

1. z. Ekrem Merovci, zyrtar komunal për kthim dhe ri integrim, i lejohej pjesëmarrja në punëtori lidhur me "Implementimin e Udhëzuesit për Qasjen e të Huajve në Aftësimin Profesional dhe Punësim", organizuar nga Caritasi Zviran në Kosovë në bashkëpunim me Departamentin për Ri integrim të Personave të Riatdhesuar dhe Riintegrimin e të Huajve në kuadër të MPB.
2. Punëtorja do të mbahet nga data 10-12 maj 2023 në Hotel "Magra", Bogë, Rugovë.
3. Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit.



Erir Idrizi

Kryetar i Komunës

Vendimi iu dërgohet:

- Z. Ekrem Merovci
- Arkivit të Sekretarisë

REPUBLICA E KOSOVËS
KOMUNA E VUSHTRRI
02 Nr./Br 549/23
Nr. i fq./ Br. sh
Data/ Daton 05.05.2023
VUSHTRRI - VUCITRN



REPUBLICA E KOSOVËS - KOMUNA VUSHTRRI

Kryetari



Bazuar në nenin 13 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040, nenin 44 paragrafi 1 të Statutit të Komunës, dhe nenin 2 të Rregullores (KKV) Nr.01/22, nr. protokollit 157/22, datë 30.06.2022 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Rregullores (KKV) Nr. 03/2020 datë 27.02.2020 për Përkrahjen e Fermerëve në Bujqësi dhe Bizneseve në Sektorin Privat, Kryetari i Komunës merr këtë:

V E N D I M

1. Lejohet subvencionimi i fermerëve të Komunës së Vushtrrisë me nga 0.05 € (pesë cent) për litër qumësht të dorëzuar në pikat grumbulluese ose direkt në qumështore.
2. Pagesa të bëhet për 107 (njëqind e shtatë) fermerë të komunës së Vushtrrisë të cilët janë të përfshirë në listën e Drejtorisë për Ekonomi Bujqësi Pylltari dhe Zhvillim Rural datë 05.03.2023, bashkëngjitur në shtojcë të këtij vendimi, e që janë përfitues të këtij subvencionit. Sasia e qumështit që subvencionohet: 1470680 litra, vlera e subvencionit: 73,534.45 €.
3. Pagesat të kryhen nga mjetet buxhetore (subvencione dhe transfere) të Drejtorisë për Ekonomi Bujqësi Pylltari dhe Zhvillim Rural.
4. Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdesen: Drejtoria për Ekonomi Bujqësi Pylltari dhe Zhvillim Rural, Drejtoria për Buxhet dhe Financa.
5. Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit.

Ferit Idrizi

Kryetar i Komunës



Vendimi iu dërgohet:

- Drejtorisë për Ekonomi Bujqësi Pylltari dhe Zhvillim Rural
- Drejtorisë për Buxhet dhe Financa
- Arkivit të Sekretarisë.



REPUBLICA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVO
KOMUNA E VUSHTRRISË-OPËSTINA VUÇITRN

02 Nr. / Br 570/23

Nr. i fq. / Br. sf _____

Data: / Datum 15.05.2023

VUSHTRRI - VUÇITRN



REPUBLICA E KOSOVËS - KOMUNA VUSHTRRI

Kryetari

Bazuar në nenin 13 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040, nenin 44 paragrafi 1 të Statutit të Komunës, nenit 12 paragrafi 1 nënparagrafi 1.1 i Rregullores (KKV) Nr. 03/2023 nr. prot. 49/23, datë 23.02.2023 për Përcaktimin e Kriteve të Ndarjes së Mjeteve Financiare nga Fondi për Transfere dhe Subvencione Personave Juridikë – OJQ-ve dhe Ndhimë Momentale Personave Fizikë dhe Bashkëfinancim, si dhe në bazë të propozimit të Drejtorisë për Kulturë Rini dhe Sport, Kryetari i Komunës merr këtë:

V E N D I M

1. z. Driton Jakupi nga fsh. Shalë Komuna e Vushtrrisë, nr. personal _____ i lejohen mjete financiare në shumë prej 499.00 € (katërqind e nëntëdhjetë e nëntë euro), ndihmë financiare për mbulim të shpenzimeve të realizimit të projektit “këngë për Dëshmorët e Qyqavicës”.
2. Pagesa e mjeteve në shumën e cekur në pikën paraprake të këtij vendimi të bëhet nga buxheti i Drejtorisë për Kulturë Rini dhe Sport – subvencione dhe transfere, në llogarinë bankare të të njëjtit, pas plotësimit të kriteve të përcaktuara në Rregulloren (KKV) Nr. 03/2023 nr. prot. 49/23, datë 23.02.2023 për Përcaktimin e Kriteve të Ndarjes së Mjeteve Financiare nga Fondi për Transfere dhe Subvencione Personave Juridikë – OJQ-ve dhe Ndhimë Momentale Personave Fizikë dhe Bashkëfinancim .
3. Drejtoria për Kulturë Rini dhe Sport duhet të lidhë marrëveshje me përfituesin e subvencionit për shfrytëzim të mjeteve financiare të përcaktuar në këtë vendim, bazuar në Rregullën Financiare të Ministrisë së Financave nr. 01/2013 Shpenzimi i Parave Publike.
4. Për zbatimin e këtij vendimi obligohen: Drejtorinë për Kulturë Rini dhe Sport dhe Drejtoria për Buxhet dhe Financa.
5. Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit.



Erërit Idrizi

Kryetar i Komunës

Vendimi i dërgohet:

- Drejtorisë për Buxhet dhe Financa
- Drejtorisë për Kulturë Rini dhe Sport
- Arkivit të Sekretarisë.

REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVO
KOMUNA E VUSHTRRIË-OPËSTINA VUÇITRN

02 Nr. / Br 571/23

Nr. i fq. / Br. st

Data: / Datum 15.05.2023

VUSHTRRI - VUÇITRN



REPUBLIKA E KOSOVËS - KOMUNA VUSHTRRI
Kryetari



Bazuar në nenin 13 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040, nenin 44 paragrafi 1 të Statutit të Komunës, nenit 12 paragrafi 1 nënparagrafi 1.1 i Rregullores (KKV) Nr. 03/2023 nr. prot. 49/23, datë 23.02.2023 për Përcaktimin e Kriteve të Ndarjes së Mjeteve Financiare nga Fondi për Transfere dhe Subvencione Personave Juridike – OJQ-ve dhe Ndhimë Momentale Personave Fizike dhe Bashkëfinancim, si dhe në bazë të propozimit të Drejtorisë për Kulturë Rini dhe Sport datë 03 maj 2023, Kryetari i Komunës merr këtë:

V E N D I M

1. Z. Berat Mernica nga Vushtrria, nr. personal _____ i lejohen mjete financiare në shumë prej 300.00 € (treqind euro), ndihmë financiare për mbulim të shpenzimeve të realizimit të një INTRO për të promovuar bukuritë natyrore dhe monumenteve kulturore të cilat do të mund të i vizitojnë turistët në komunën e Vushtrrië.
2. Pagesa e mjeteve në shumën e cekur në pikën paraprake të këtij vendimi të bëhet nga buxheti i Drejtorisë për Kulturë Rini dhe Sport – subvencione dhe transfere, në llogarinë bankare të të njëjtit, pas plotësimit të kriteve të përcaktuara në Rregulloren (KKV) Nr. 03/2023 nr. prot. 49/23, datë 23.02.2023 për Përcaktimin e Kriteve të Ndarjes së Mjeteve Financiare nga Fondi për Transfere dhe Subvencione Personave Juridike – OJQ-ve dhe Ndhimë Momentale Personave Fizike dhe Bashkëfinancim .
3. Drejtoria për Kulturë Rini dhe Sport duhet të lidhë marrëveshje me përfituesin e subvencionit për shfrytëzim të mjeteve financiare të përcaktuar në këtë vendim, bazuar në Rregullën Financiare të Ministrisë së Financave nr. 01/2013 Shpenzimi i Parave Publike.
4. Për zbatimin e këtij vendimi obligohen: Drejtorinë për Kulturë Rini dhe Sport dhe Drejtoria për Buxhet dhe Financa.
5. Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit.



Ferit Idrizi

Kryetar i Komunës

Vendimi i dërgohet:

- Drejtorisë për Buxhet dhe Financa
- Drejtorisë për Kulturë Rini dhe Sport
- Arkivit të Sekretarisë.



REPUBLICA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVO
KOMUNA E VUSHTRRIË-OPËSTINA VUÇITRN

02 Nr. / Br 573 / 23

Nr. i fq. / Br. st _____

Data: / Datum 15.05.2023

VUSHTRRI - VUÇITRN



REPUBLICA E KOSOVËS - KOMUNA VUSHTRRI
Kryetari

Bazuar në nenin 13 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale nr. 03/L-040, nenin 8 paragrafi 4 dhe 5 të Rregullores së MF nr.02/2013 për Menaxhimin e Pasurisë jo Financiare në Organizatat Buxhetore dhe nenin 44 paragrafi 1 të Statutit të Komunës, Kryetari i Komunës merr këtë:

V E N D I M
PËR FORMIM TË KOMISIONIT

1. Me këtë vendim formohet komisioni për identifikim të varrezave të martirëve të luftës në Komunën e Vushtrrisë, në këtë përbërje:
 - 1.1 Burim Rexhepi, kryesues i komisionit
 - 1.2 Izet Miftari, anëtar
 - 1.3 Shukrane Begu, anëtare
 - 1.4 Vildane Mulaku, anëtare
2. Komisioni në përbërje të cekur si në pikën paraprake të këtij vendimi do të bëjë identifikimin e të gjitha varrezave të martirëve të të gjitha masakrave në territorin e Komunës së Vushtrrisë.
3. Lidhur me të gjeturat në terren, Komisioni do të përpilojë raport me shkrim dhe dorëzojë në zyrën e Kryetarit të Komunës në afat sa më të shkurtër.
4. Komisioni duhet të fillojë me punë menjëherë.
5. Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit.



Ferit Idrizi

Ferit Idrizi
Kryetar i Komunës

Vendimi iu dërgohet:

- Drejtores së DKRS
- Anëtarëve të Komisionit
- Arkivit të Sekretarisë



REPUBLICA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVO
KOMUNA E VUSHTRRIË-OPŠTINA VUÇITRN

02 Nr. / Br 585/23

Nr. i fq. / Br. st _____

Data: / Datum 17.05.2023

VUSHTRRI - VUÇITRN



REPUBLICA E KOSOVËS - KOMUNA VUSHTRRI
Kryetari

Bazuar në nenin 13 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040 dhe nenin 43 paragr. 14 dhe 44 paragr. 1 të Statutit të Komunës si dhe propozimin e Drejtorisë për Arsim dt.16.05.2023, Kryetari i Komunës merr këtë:

V E N D I M
PËR FORMIM TË KËSHILLIT ORGANIZATIV

1. Formohet Këshilli Organizativ për organizim të manifestimit 1 Qershori – Dita Ndërkombëtare e Fëmijëve që do të mbahet në Komunën e Vushtrrisë, më 01.06.2023.
2. Në përbërje të Këshillit Organizativ caktohen:
 - 2.1 z. Urim Qirezi, Kryesues i Këshillit Organizativ
 - 2.2 znj. Kadrije Meniqi, anëtare
 - 2.3 z. Dardan Abazi, anëtar
 - 2.4 znj. Medina Bunjaku, anëtare
 - 2.5 z. Gëzim Saraqi, anëtar
 - 2.6 znj. Qefsere Galica, anëtare
 - 2.7 znj. Nazmije Qerkezi, anëtare
 - 2.8 znj. Mirjeta Duraku, anëtare
3. Këshilli organizativ në përbërje të cekur si në pikën paraprake të këtij vendimi do të ndërmerr të gjitha masat e duhura rreth organizimit dhe mbarëvajtjes së këtij manifestimi.
4. Kryesuesi i KO në koordinim me Drejtoreshën e DKRS do të informojnë me kohë Kryetarin e Komunës lidhur me përgatitjet për këtë manifestim.
5. Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit.



Vendimi i dërgohet:

- Drejtorisë për Arsim
- Anëtarëve të Këshillit Organizativ
- Arkivit të Sekretarisë.



REPubLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVO
KOMUNA E VUSHTRRISË-OPŠTINA VUÇITRN

02 Nr. / Br 594/23

Nr. i fq. / Br. sf _____

Data: / Datum 19.05.2023

VUSHTRRI - VUÇITRN



REPUBLIKA E KOSOVËS - KOMUNA VUSHTRRI
Kryetari

Bazuar në nenin 13 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale nr. 03/L-040 dhe nenin 44 paragrafi 1 të Statutit të Komunës, Kryetari i komunës merr këtë:

V E N D I M

1. znj. Remzije Zekolli, zyrtare për barazi gjinore, i lejohet pjesëmarrja në punëtori më 25 dhe 26 maj 2023 në Hotel "Dukagjini" në Pejë, në temën, Mbrojtja nga Diskriminimi dhe Standardet e Barazisë.
2. Zyrtarja nga pika paraprake e këtij vendimi i realizon mbulimin e shpenzimeve të pjesëmarrjes në këtë punëtori bazuar në legjislacionin në fuqi.
3. Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit.




Ferit Idrizi

Kryetar i Komunës

Vendimi iu dërgohet:

- Znj. Remzije Zekolli
- Arkivit të Sekretarisë



REPUBLIKA E KOSOVËS - KOMUNA VUSHTRRI
Kryetari

Bazuar në nenin 13 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale nr. 03/L-040 dhe nenin 44 paragrafi 1 të Statutit të Komunës, si dhe ftesën e GIZ-it Gjerman datë 19 maj 2023, Kryetari i komunës merr këtë:

V E N D I M

1. Lejohet udhëtimi zyrtar në Shkup, Maqedoni e Veriut, nga data 23-24 maj 2023 i zyrtarëve të komunës të shënuar si në vijim:
 - 1.1 Islam Latifi, Drejtoria për Shërbime Publike
 - 1.2 Arben Mlinaku, Drejtoria për Shërbime Publike
2. Qëllimi i udhëtimit zyrtar i organizuar nga GIZ-i është pjesëmarrja në punëtorinë me temën “Shërbime të Qëndrueshme Komunale”.
3. Pagesa e mëditjeve do të bëhet nga buxheti i komunës, konform legjislacionit në fuqi ndërsa shpenzimet e udhëtimit dhe qëndrimit do të paguhet nga GIZ-i.
4. Ftesa dhe agjenda janë të bashkëngjitur në shtojcë të këtij vendimi.
5. Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit.



Ferit Idrizi

Kryetar i Komunës

Vendimi iu dërgohet:

- Drejtorisë për Buxhet dhe Financa
- Zyrtarëve të shënuar në këtë vendim
- Arkivit të sekretarisë



Republika e Kosovës
Republika Kosovo – Republik of Kosovo
Komuna e Vushtrrisë
Opština Vučitrn – Municipality of Vushtrri

Bazuar në nenin 13 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040, nenin 67 shkronja “g” të Statutit të Komunës si dhe Rregulloren 01nr.68/15, dt. 26.03.2015 për Përdorimin e Automjeteve Zyrtare në Komunën e Vushtrrisë, Kryetari i Komunës jep këtë:


AUTORIZIM

1. z. **Islam Latifi**, Zyrtar në Drejtorinë për Shërbime Publike, me nr. personal 1021566710 autorizohet që të përdor automjetin zyrtar të Komunës për udhëtim zyrtar në Shkup Maqedoni e Veriut nga data 23-24 maj 2023.
2. Të dhënat për automjetin zyrtar: Nr. i regjistrimit 02Z-31-27, prodhuesi: “Toyota”, tipi “Prado” ngjyrë e bardhë.



Ferit Idrizi

Kryetar i Komunës



REPUBLIKA E KOSOVËS - KOMUNA VUSHTRRI
Kryetari




Bazuar në nenin 13 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale nr. 03/L-040 dhe nenin 44 paragrafi 1 të Statutit të Komunës, Kryetari i Komunës merr këtë:

V E N D I M

1. Me këtë vendim caktohet delegacionit i komunës për udhëtim zyrtar në Greqi me datën 26 dhe 27 maj 2023 në këtë përbërje:
 - 1.1 z. Ferit Idrizi, Kryetar i Komunës
 - 1.2 z. Dardan Abazi, Drejtor për Arsim
 - 1.3 z. Bujar Shatrolli, Shef i Kabinetit të Kryetarit të Komunës
2. Shpenzimet e udhëtimit zyrtar për ditët e cekura në pikën 1 të këtij vendimi të paguhet nga buxheti i komunës – Drejtoria për Buxhet dhe Financa, konform legjislacionit në fuqi.
3. Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit.



Ferit Idrizi


Kryetar i Komunës

Vendimi iu dërgohet:

- Drejtorisë për Buxhet dhe Financa,
- Arkivit të sekretarisë